

31985R3821

Rregullore e Këshillit (KEE) nr. 3821/85, datë 20 dhjetor 1985 për pajisjet e regjistrimit të transportin rrugor

Gazeta Zyrtare L 370 , 31/12/1985 fq. 0008 – 0021

Botim i Posaçëm Finlandez: Kapitulli 7, Vëllimi 3, fq. 0120

Botim i Posaçëm Spanjoll: Kapitulli 7, Vëllimi 4, fq. 0028

Botim i Posaçëm Suedez: Kapitulli 7, Vëllimi 3, fq. 0120

Botim i Posaçëm Portugez: Kapitulli 7, Vëllimi 4 fq. 0028

Rregullore e Këshillit (KEE) nr. 3821/85, datë 20 dhjetor 1985 për pajisjet e regjistrimit të transportit rrugor

KËSHILLI I KOMUNITETEVE EUROPIANE,

Duke marrë parasysh Traktatin e themelimit të Komunitetit Ekonomik Europian, dhe në mënyrë të veçantë nenin 7 të tij,

Duke marrë parasysh propozimin nga Komisioni [1],

Duke marrë parasysh opinionin e Parlamentit Europian [2],

Duke marrë parasysh opinionin e Komitetit Ekonomik dhe Social [3],

Duke pasur parasysh se Rregullorja (KEE) nr. 1463/70 [4] e ndryshuar në fund nga Rregullorja (KEE) nr. 2828/77 (5) prezantoi pajisjet e regjistrimit në transportin rrugor;

Duke pasur parasysh se, për shkak të ndryshimeve të shprehura në vijim, dhe për të sqaruar çështjet, të gjitha dispozitat e lidhura duhen bashkuar në një tekst të vetëm, dhe si rrjedhojë, Rregullorja (KEE) nr. 1463/70 e Këshillit duhet shfuqizuar; sidoqoftë, përjashtimet e përcaktuara në nenin 3 pika 1 për shërbime të caktuara pasagjerësh duhen mbajtur në fuqi për një kohë të caktuar;

Duke pasur parasysh se përdorimi i pajisjeve të regjistrimit që mund të tregojnë periudhat kohore të përmendura në Rregulloren (KEE) nr. 3820/85 për harmonizimin e legjislacionit të caktuar social, që lidhet me transportin rrugor [6] synon të sigurojë kontroll efikas mbi këtë legjislacion social;

Duke pasur parasysh se detyrimi për të përdorur pajisje të tilla regjistrimi mund të imponohet vetëm për automjetet e regjistruara në Shtetet Anëtare; duke pasur parasysh se më tej disa prej automjeteve të tilla mund të përjashtohen nga objekti i kësaj rregulloreje pa krijuar vështirësi;

Duke pasur parasysh se Shtetet Anëtare duhet të kenë të drejtë, me autorizim të Komisionit, të bëjnë përjashtime për automjete të caktuara nga dispozitat e rregullores në rrethana të veçanta; duke pasur parasysh se, në raste urgjente, duhet të jetë e mundur që të bëhen këto përjashtime për një kohë të kufizuar pa autorizim paraprak nga Komisioni;

Duke pasur parasysh se, për të siguruar kontroll efikas, pajisja duhet të jetë e besueshme në përdorim, e lehtë për t'u përdorur dhe e modeluar në mënyrë të tillë që të minimizojë çdo mundësi përdorimi të falsifikuar; duke pasur parasysh se për këtë qëllim pajisja e regjistrimit duhet të jetë

veçanërisht e aftë të japë në fleta të ndara për çdo drejtues mjete dhe në një formë mjaft të saktë dhe lehtësisht të lexueshme, detaje të regjistruara të periudhave të ndryshme kohore;

Duke pasur parasysh se regjistrimi automatik i detajeve të tjera të udhëtimit të një mjete, siç është shpejtësia dhe distanca e përshkuar, do të kontribuojë dukshëm në drejtim të sigurisë rrugore dhe do të inkurajojnë drejtim të ndjeshëm të automjetit; duke pasur parasysh se, rrjedhimisht, duket e përshtatshme për të treguar kujdes për pajisjen edhe për të regjistruar këto të dhëna;

Duke pasur parasysh se është e nevojshme të vendosen standardet e prodhimit dhe të instalimit të pajisjeve të regjistrimit, dhe të përcaktohet një procedurë miratimi e KEE-së, me qëllim që të shmanget në të gjithë territorin e Shteteve Anëtare çdo pengesë ndaj regjistrimit të automjeteve të pajisura me një pajisje të tillë regjistrimi, ndaj hyrjes së tyre në shërbim ose në përdorim, ose ndaj pajisjeve të tilla kur janë në përdorim;

Duke pasur parasysh se, në rast të mospërputhjes së opinionëve ndërmjet Shteteve Anëtare lidhur me rastet e miratimeve tip të KEE-së, Komisionit i duhet dhënë fuqi për të marrë një vendim ndaj një mosmarrëveshje brenda gjashtë muajve nëse shtetet në fjalë nuk kanë qenë në gjendje të arrijnë një zgjidhje;

Duke pasur parasysh se do të ishte e dobishme gjatë zbatimit të kësaj rregulloreje dhe për parandalimin e abuzimeve për pajisjen e drejtuesve të mjetit me një kopje të fletës së tyre të të dhënave kur ata e kërkojnë atë;

Duke pasur parasysh se, për të realizuar synimet e përmendura me sipër për mbajtjen e një kontrolli mbi punën dhe periudhat e pushimit, është e nevojshme që punëdhënësit dhe drejtuesit e mjeteve të jenë përgjegjës për të parë se pajisja funksionon në mënyrë të saktë dhe se ata realizojnë me kujdesin e duhur veprimet e përcaktuara;

Duke pasur parasysh se dispozitat, të cilat rregullojnë numrin e fletëve të regjistrimit që një drejtues mjete duhet të mbajë me vete, duhen ndryshuar pas zëvendësimit të javës fleksibël me javën fikse;

Duke pasur parasysh se progresi teknik shtron domosdoshmërinë e miratimit të shpejtë të specifikimeve teknike të përcaktuara në Shtojcat e kësaj rregulloreje; duke pasur parasysh se, me qëllim që të lehtësohet zbatimi i masave të nevojshme për këtë qëllim, duhen hartuar dispozita për një procedurë të krijimit të një bashkëpunimi të ngushtë ndërmjet Shteteve Anëtare dhe Komisionit brenda një Komiteti Këshillues;

Duke pasur parasysh se Shtetet Anëtare duhet të shkëmbejnë informacionin e disponueshëm për shkeljet e kryera;

Duke pasur parasysh se, për të siguruar që pajisja e regjistrimit funksionon në mënyrë të besueshme dhe të saktë, është e këshillueshme që të parashikohen kërkesa uniforme për kontrolle dhe inspektime periodike, subjekt i të cilave bëhet pajisja pas instalimit;

KA MIRATUAR KËTË RREGULLORE:

KAPITULLI I PARIMET DHE OBJEKTI

Neni 1

Pajisja e regjistrimit në kuptim të kësaj rregulloreje respekton, për sa i përket prodhimit, instalimit, përdorimit dhe testimit, kërkesat e kësaj rregulloreje dhe të Shtojcave I dhe II të saj, të cilat janë pjesë integrale e kësaj rregulloreje.

Neni 2

Për qëllimet e kësaj rregulloreje, do të zbatohen përkufizimet e dhëna në nenin 1 të Rregullores (KEE) nr. 3820/85.

Neni 3

1. Pajisja e regjistrimit instalohet dhe përdoret në automjetet e regjistruara në një Shtet Anëtar, të cilat përdoren për transportimin e pasagjerëve ose të mallrave me rrugë tokësore, me përjashtim të automjeteve të përmendura në nenet 4 dhe 14 pika (1) të Rregullores (KEE) nr. 3820/85.

2. Shtetet Anëtare mund të përjashtojnë automjetet e përmendura në nenin 13 pika 1 të Rregullores (KEE) nr. 3820/85 nga zbatimi i kësaj rregulloreje. Shtetet Anëtare duhet të informojnë Komisionin për çdo përjashtim të bërë sipas këtij paragrafi.

3. Pas autorizimit nga Komisioni, Shtetet Anëtare mund të përjashtojnë nga zbatimi i kësaj rregulloreje automjetet që përdoren për operacionet e transportit të përmendura në nenin 13 pika 2 të Rregullores (KEE) nr. 3820/85. Në raste urgjente, ato mund të bëjnë përjashtime të përkohshme për një periudhë që nuk i kalon 30 ditë, gjë e cila duhet t'i njoftohet menjëherë Komisionit. Komisioni njofton Shtetet e tjera Anëtare për çdo përjashtim të dhënë në bazë të këtij paragrafi.

4. Në rastin e operacioneve të transportit kombëtar, Shtetet Anëtare mund të kërkojnë instalimin dhe përdorimin e pajisjeve të regjistrimit në përputhje me këtë rregullore në çdo automjet, për të cilin instalimi dhe përdorimi i pajisjes nuk kërkohen nga paragrafi 1.

KAPITULLI II MIRATIMI I TIPIT

Neni 4

Kërkesat për miratimin e tipit KEE për pajisjen e regjistrimit apo për një model flete regjistrimi duhet të dorëzohen, të shoqëruara nga specifikimet e duhura, nga prodhuesi apo agjenti i tij tek Shteti Anëtar. Asnjë kërkesë në lidhje me ndonjë lloj pajisje regjistrimi apo me ndonjë model flete regjistrimi nuk mund të dorëzohet tek më shumë se një Shtet Anëtar.

Neni 5

Shteti Anëtar jep miratimin KEE për çdo lloj pajisje regjistrimi apo model flete regjistrimi që respekton kërkesat e parashtruara në Shtojcën I të kësaj rregulloreje, me kusht që Shteti Anëtar është në gjendje që të kontrollojë nëse modelet e prodhimit përputhen me prototipin e miratuar. Të gjitha modifikimet apo shtesat e një miratimi duhet të marrin miratim tip shtesë KEE nga Shteti Anëtar që ka dhënë miratimin tip origjinal KEE.

Neni 6

Shtetet Anëtare pajisin kërkuesin me një shenjë miratimi, e cila duhet të përputhet me modelin e treguar në Shtojcën II, për çdo lloj pajisje regjistrimi apo modeli flete regjistrimi, të cilin ata e miratojnë në zbatimin të nenit 5.

Neni 7

Në funksion të secilës lloj pajisje regjistrimi ose modeli flete regjistrimi, autoritetet kompetente të Shteteve Anëtare, të cilëve u është bërë kërkesa për miratimin e tipit, të cilën ata e miratojnë ose refuzojnë të miratojnë, ose u dërgojnë autoriteteve Shteteve të tjera Anëtare brenda një muaji një kopje të certifikatës së miratimit të shoqëruar me kopje të specifikimeve përkatëse, ose, nëse rasti është i tillë, i njoftojnë këto autoritete që miratimi është refuzuar; në rastet e refuzimit ata duhet të bëjnë të ditura edhe arsyet e vendimit të tyre.

Neni 8

1. Nëse një Shtet Anëtar, i cili ka dhënë miratimin e tipit KEE siç parashikohet në nenin 5, vëren se një pajisje e caktuar regjistrimi ose fletë regjistrimi që mban shenjën e miratimit të tipit, të cilën e ka lëshuar Shteti Anëtar, nuk përputhet me prototipin që Shteti Anëtar ka miratuar, Shteti Anëtar duhet të marrë masat e nevojshme me qëllim që modelet e prodhimit të përputhen me prototipin e miratuar. Masat e marra mund të zgjerohen, nëse është e nevojshme, deri tek tërheqja e miratimit të tipit KEE.

2. Një Shtet Anëtar, i cili ka dhënë miratimin e tipit KEE, e tërheq një miratim të tillë nëse pajisja e regjistrimit apo modeli i fletës së regjistrimit, të cilat janë miratuar, nuk janë në përputhje me këtë rregullore apo me Shtojcat e saj ose shfaq gjatë përdorimit ndonjë defekt të përgjithshëm që e bën atë të papërshtatshme për qëllimin, për të cilin ajo është parashikuar.

3. Një Shtet Anëtar, i cili ka dhënë miratimin e tipit KEE, njoftohet nga një Shtet tjetër Anëtar për një prej rasteve të përmendura në paragrafët 1 dhe 2, ai ndërmerr hapat e përcaktuar në këta paragrafë, subjekt i paragrafit 5.

4. Një Shtet Anëtar, i cili konstaton se ka ndodhur njëri prej rasteve të përmendura në paragrafin 2, mund të ndalojë deri në një lajmërim të mëtejshëm nxjerrjen në treg dhe vënien në shërbim të pajisjes së regjistrimit dhe të fletëve të regjistrimit. E njëjta gjë zbatohet në rastet e përmendura në paragrafin 1 në lidhje me pajisjet e regjistrimit apo fletët e regjistrimit, të cilat janë përjashtuar nga verifikimi fillestar i KEE-së, nëse prodhuesi, pas njoftimit të duhur, nuk e sjell pajisjen në linjë me modelin e miratuar apo me kërkesat e kësaj rregulloreje. Në çdo rast, autoritetet kompetente të Shteteve Anëtare duhet të njoftojnë njëri-tjetrin dhe Komisionin, brenda një muaji, për çdo tërheqje të miratimit të tipit KEE, apo për ndonjë masë tjetër të ndërmarrë në zbatim të paragrafëve 1, 2 dhe 3 dhe duhet të specifikojë arsyet e një veprimi të tillë.

5. Nëse një Shtet Anëtar, i cili ka dhënë një miratim tipi KEE, kundërshton ekzistencën e ndonjërit prej rasteve të specifikuar në paragrafët 1 ose 2, për të cilat është vënë në dijeni, Shteti Anëtar në fjalë duhet të bëjë përpjekje për ta zgjidhur mosmarrëveshjen dhe Komisioni duhet të mbahet i informuar.

Nëse bisedimet ndërmjet Shteteve Anëtare nuk kanë rezultuar në marrëveshje brenda katër muajsh nga data e njoftimit të përmendur në paragrafin 3, më sipër, Komisioni, pas konsultimit me ekspertë nga të gjitha Shtetet Anëtare dhe pasi ka shqyrtuar të gjithë faktorët e lidhur, për shembull, faktorët ekonomik dhe teknik, duhet të miratojë brenda gjashtë muajve një vendim, i cili i duhet komunikuar Shteteve Anëtare në fjalë dhe në të njëjtën kohë, edhe Shteteve të tjera Anëtare. Komisioni përcakton në çdo rast afatin kohor për zbatimin e vendimit të tij.

Neni 9

1. Një kërkues për miratimin e tipit KEE për një model flete regjistrimi duhet të shprehë në kërkesën e tij llojin ose llojet e pajisjeve regjistruese, mbi bazën e të cilave është modeluar fleta në fjalë për t'u përdorur dhe duhet të sigurojë pajisje të përshtatshme për një tip apo tipa të tilla me qëllim që të provojë fletën.

2. Autoritetet kompetente të çdo Shteti Anëtar duhet të tregojnë në certifikatën e miratimit modelin e fletës së regjistrimit, tipin ose tipat e pajisjes së regjistrimit në të cilin mund të përdoret ai model flete.

Neni 10

Asnjë Shtet Anëtar nuk mund të refuzojë regjistrimin e mjeteve të pajisura me pajisjen e regjistrimit, apo të ndalojë hyrjen në shërbim apo në përdorim të mjeteve të tilla për ndonjë arsye të lidhur me faktin që automjeti është i pajisur me një pajisje të tillë, nëse pajisja mban shenjen e miratimit KEE të përshkruar në nenin 6 dhe pllakën e instalimit të përshkruar në nenin 12.

Neni 11

Të gjitha vendimet në zbatim të kësaj rregulloreje që refuzojnë apo revokojnë një miratim të tipit të pajisjes së regjistrimit apo të modelit të fletës së regjistrimit, duhet të specifikojnë në detaje arsyet mbi të cilat ata janë bazuar. Vendimi i duhet komunikuar palës në fjalë, e cila, në të njëjtën kohë, informohet për zgjidhjet e disponueshme ligjore për të sipas ligjeve të Shteteve Anëtare dhe për afatet kohore për ushtrimin e zgjidhjeve të tilla.

KAPITULLI III INSTALIMI DHE INSPEKTIMI

Neni 12

1. Pajisja e regjistrimit mund të instalohet apo të riparohet vetëm nga montuesit apo njësitë e riparimit të miratuara nga autoritetet kompetente të Shteteve Anëtare për këtë qëllim, pasi këto të fundit të kenë dëgjuar pikëpamjet e prodhuesve në fjalë, nëse ato e dëshirojnë një gjë të tillë,.

2. Montuesi apo njësia e miratuar e riparimit duhet të vendosë një shenjë të veçantë në vulën që vendos. Autoritetet kompetente të çdo Shteti Anëtar duhet të mbajnë një regjistër të shenjave të përdorura.

3. Autoritetet kompetente të Shteteve Anëtare i dërgojnë njëri-tjetrit listat e tyre të montuesve ose të njërive të riparimit të miratuara, si dhe kopje të shenjave të përdorura.

4. Për qëllimet e certifikimit që instalimi i pajisjes regjistruese është bërë në përputhje me kërkesat e kësaj rregulloreje, duhet të përdoret një pllakë instalimi e vendosur siç përcaktohet në Shtojcën I.

KAPITULLI IV PËRDORIMI I PAJISJES

Neni 13

Punëdhënësi dhe drejtuesi i mjetit janë përgjegjës për të parë nëse pajisja funksionon apo jo në mënyrë të saktë.

Neni 14

1. Punëdhënësi duhet të përdorë një numër të mjaftueshëm fletësh regjistrimi për drejtuesit e mjeteve, duke pasur parasysh faktin se këto fletë janë personale në karakterin, kohëzgjatjen e shërbimit dhe detyrimin e mundshëm për të zëvendësuar fletët që janë dëmtuar apo që janë marrë nga zyrtari inspektues i autorizuar. Punëdhënësi duhet t'i pajisë drejtuesit e mjeteve vetëm me

fletët e një modeli të miratuar që është i përshtatshëm për përdorim në pajisjen e instaluar në automjet.

2. Ndërmarrja mban fletët e regjistrimit për, të paktën, një vit pas përdorimit të tyre dhe duhet t'u japë kopje drejtuesve të mjeteve në fjalë që i kanë kërkuar ato. Fletët duhen të paraqiten ose të dorëzohen me kërkesë të çdo zyrtari inspektues të autorizuar.

Neni 15

1. Drejtuesit e mjeteve nuk duhet të përdorin fletë regjistrimi të papastra apo të dëmtuara. Për këtë qëllim fletët duhen mbrojtur mirë. .

Në rast dëmtimi të një flete që përmban regjistrime, drejtuesit duhet ta bashkëlidhin fletën e dëmtuar me fletën rezervë të përdorur për ta zëvendësuar atë.

2. Drejtuesit duhet të përdorin fletët e regjistrimit çdo ditë që ata udhëtojnë duke filluar nga momenti që ata marrin në dorëzim automjetin. Fleta e regjistrimit nuk duhet tërhequr përpara përfundimit të periudhës së ditës së punës, përveç rastit kur tërheqja e saj autorizohet ndryshe. Asnjë fletë regjistrimi nuk mund të përdoret për të mbuluar një periudhë më të gjatë sesa ajo për të cilën është parashikuar. Kur, si rezultat i të qenit larg automjetit, drejtuesi i mjetit nuk është në gjendje të përdorë pajisjen e instaluar në automjet, periudhat kohore të treguara në paragrafin 3, nënparagrafët (b), (c) dhe (d), më poshtë hidhen në fletë në mënyrë manuale, nëpërmjet regjistrimit automatik apo me mjete të tjera, në mënyrë të lexueshme dhe pa ndotur fletën.

Drejtuesit e mjeteve i ndryshojnë fletët e regjistrimit sipas kërkesës nëse në automjet ka më shumë se një drejtues mjeti, në mënyrë që informacioni i përmendur në Kapitullin II (1) deri tek (3) i Shtojcës I të regjistrohet në fletën e regjistrimit të drejtuesit të mjetit që është faktikisht duke drejtuar automjetin.

3. Drejtuesit e mjeteve duhet:

- të sigurojnë që koha e regjistruar në fletë përputhet me kohën zyrtare të vendit të regjistrimit të automjetit,

- të përdorin mekanizmat çelës për të mundësuar që periudhat kohore të paraqitura më poshtë të regjistrohen veçmas dhe në mënyrë të dallueshme:

(a) nën shenjën : koha e udhëtimit;

(b) nën shenjën : të gjitha periudhat e tjera të punës;

(c) nën shenjën : periudhat e tjera të disponueshmërisë, më saktë:

- kohën e pritjes, domethënë periudhën gjatë së cilës drejtuesit e mjeteve duhet të qëndrojnë në postet e tyre vetëm për qëllimin e përgjigjes së thirrjeve për të nisur ose për të rifilluar drejtimin e automjetit ose për të kryer punë të tjera,

- kohën e shpenzuar pranë drejtuesit të mjetit teksa automjeti është në lëvizje,

- kohën e shpenzuar në krevat marinari teksa automjeti është në lëvizje;

(d) nën shenjën : pushime gjatë punës dhe periudhat e pushimit ditor.

4. Çdo Shtet Anëtar mund të lejojë të gjithë periudhat e përmendura në paragrafin 3, nënparagrafët (b) dhe (c) që të regjistrohen nën shenjën tek fletët e regjistrimit të përdorura në automjetet e regjistruara në territorin e tij.

5. Çdo anëtar i ekipit duhet të hedhë në fletën e regjistrimit të tij informacionin e mëposhtëm:

(a) në fillimin e përdorimit të fletës – mbiemrin dhe emrin e tij;

(b) datën dhe vendin ku fillon përdorimi i fletës dhe datën e vendin ku përfundon një përdorim i tillë;

(c) targën e çdo automjeti të cilin ai është caktuar të drejtojë, si në nisje të udhëtimit të parë të regjistruar në fletë, ashtu edhe në rast të ndryshimit të automjetit, gjatë përdorimit të fletës;

(d) leximin e odometrit:

- në fillim të udhëtimit të parë të regjistruar në fletë,

- në fund të udhëtimit të fundit të regjistruar në fletë,

- në rast të ndryshimit të automjetit gjatë ditës së punës (leximin në automjetin që i kishin caktuar për të drejtuar dhe leximin në automjetin që do t'i caktohet për të drejtuar);

(e) kohën e ndryshimit të çdo automjeti.

6. Pajisja modelohet e tillë që të jetë e mundur për një zyrtar inspektues të autorizuar, nëse është e nevojshme pas hapjes së pajisjes, të lexojë regjistrimet që i përkasin një periudhe kohore prej nëntë orësh përpara kohës së kontrollit pa e deformuar, dëmtuar apo ndotur në asnjë rast fletën.

Pajisja duhet të modelohet gjithashtu në mënyrë që të jetë e mundur që, pa hapur kutinë, të verifikohet se regjistrimet po bëhen.

7. Kurdoherë që kërkohet nga një zyrtar inspektues i autorizuar për të vepruar në këtë mënyrë, drejtuesi i mjetit duhet të jetë në gjendje të paraqesë fletët e regjistrimit për javën ekzistuese dhe në çdo rast, për ditën e fundit të javës së kaluar gjatë së cilës ai ka drejtuar automjetin.

Neni 16

1. Në rast të një defekti të automjetit apo keqfunksionim të tij, punëdhënësi duhet të riparojë atë tek një montues apo njësi riparimi e miratuar, sa më shpejt që ta lejojnë rrethanat.

Nëse automjeti nuk është në gjendje të kthehet në vendin e riparimit brenda një jave, e llogaritur që nga dita e defektit apo nga dita e zbulimit të keqfunksionimit, riparimi duhet kryer në rrugë.

Masat e marra nga Shtetet Anëtare në zbatim të nenit 19 mund t'i japin autoriteteve kompetente fuqi për të ndaluar përdorimin e automjetit në rastet kur defekti apo ndonjë keqfunksionim i tij nuk është riparuar siç përcaktohet në nënparagrafët e mësipërm.

2. Teksa automjeti është jashtë shërbimit ose funksionon me defekt, shoferët duhet të shënojnë në fletën, apo fletët e regjistrimit, ose në një fletë të përkohshme që do t'i bashkëlidhet fletës së regjistrimit, të gjithë informacionin për periudhat e ndryshme kohore që nuk është regjistruar me saktësi nga pajisja.

KAPITULLI V DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 17

Ndryshimet e nevojshme për të përshtatur Shtojcat ndaj progresit teknik duhen miratuar në përputhje me procedurën e parashikuar në nenin 18.

Neni 18

1. Krijohet një Komitet për përshtatjen e kësaj rregulloreje ndaj progresit teknik (në vijim Komiteti) përbëhet nga përfaqësues të Shteteve Anëtare, ndërkohë që përfaqësuesi i Komisionit është kryetar.

2. Komiteti do të miratojë rregullat e veta procedurale.

3. Kur duhet ndjekur procedura e parashikuar në këtë nen, çështja i referohet Komitetit nga kryetari ose kryesisht ose me kërkesë të përfaqësuesit të një Shteti Anëtar.

4. Përfaqësuesi i Komisionit dorëzon pranë Komitetit një projekt të masave që do të merren. Komiteti jep opinionin e tij mbi atë projekt brenda një afati kohor të përcaktuar nga kryetari duke pasur parasysh urgjencën e çështjes. Opinionet duhet të jepen nga një shumicë e cilësuar në përputhje me nenin 148 pika (2) të traktatit. Kryetari nuk voton.

5. (a) Komisioni miraton masat e parashikuara kur ato janë në përputhje me opinionin e Komitetit.
(b) Kur masat e parashikuara nuk janë në përputhje me opinionin e Komitetit, apo nëse Komiteti nuk ka dhënë asnjë opinion, Komisioni, pa vonesë, dorëzon pranë Këshillit një propozim për masat që do të merren. Këshilli vepron më shumicë të cilësuar.
(c) Nëse Këshilli nuk ka vepruar brenda tre muajsh nga momenti që i është dorëzuar propozimi, Komisioni miraton masat e propozuara.

Neni 19

1. Shtetet Anëtare miratojnë, në kohën e duhur dhe pas konsultimit me Komisionin, ligje, rregullore ose dispozita administrative, siç mund të jetë e nevojshme për zbatimin e kësaj rregulloreje.

Masa të tilla mbulojnë, ndër të tjera, riorganizimin e procedurave dhe mjetet për kryerjen e kontrolleve të përputhshmërisë dhe penalitetet që duhen vendosur në rast shkeljeje.

2. Shtetet Anëtare ndihmojnë njëri-tjetrin lidhur me zbatimin e kësaj rregulloreje dhe me kontrollin e respektimit të saj.

3. Në kuadër të kësaj ndihme të ndërsjellët, autoritetet kompetente të Shteteve Anëtare i dërgojnë rregullisht njëri-tjetrit të gjithë informacionin e disponueshëm lidhur me sa më poshtë vijon:
- shkeljet e kësaj rregulloreje të shkaktuara nga zoredentët dhe të gjitha penalitetet e vendosura për shkelje të tilla,
- penalitetet e vendosura nga Shtetet Anëtare ndaj rezidentëve të tyre për shkelje të tilla të shkaktuara në Shtetet e tjera Anëtare.

Neni 20

Rregullorja (KEE) nr. 1463/70 shfuqizohet.

Megjithatë neni 3 pika (1) i rregullores së përmendur do të vazhdojë të zbatohet deri me datë 31 dhjetor 1989 ndaj automjeteve dhe drejtuesve që janë të punësuar në shërbime të rregullta ndërkombëtare për pasagjerë, për aq sa automjetet që përdoren për shërbime të tilla nuk janë pajisur me pajisje regjistrimi që përdoren siç përshkruhet në këtë rregullore.

Neni 21

Kjo rregullore hyn në fuqi me datë 29 shtator 1986.

Kjo rregullore është detyruese në tërësinë e saj dhe drejtpërdrejt e zbatueshme në të gjitha Shtetet Anëtare.

Nënshkruar në Bruksel, më 20 dhjetor 1985.

Për Këshillin

Presidenti

R. Krieps

- [1] GZ nr. C 100, 12. 4. 1984, p. 3, dhe GZ nr. C 223, 3. 9. 1985, f. 5.
- [2] GZ nr. C 122, 20. 5. 1985, p. 168.
- [3] GZ nr. C 104, 25. 4. 1985, p. 4, dhe GZ nr. C 303, 25. 11. 1985, f. 29.
- [4] GZ. Nr. L 164, 27. 7. 1970, f. 1.
- [5] GZ. Nr. L 334, 24. 12. 1977, f. 11.
- [6] Shih faqen 1 të kësaj Gazete Zyrtare.

SHTOJCA I Kërkesat për prodhimin, testimin, instalimin dhe inspektimin

I. PËRKUFIZIME

Në këtë Shtojcë:

(a) Pajisje regjistrimi do të thotë:

pajisje e synuar për t'u instaluar në automjetet rrugore për të treguar regjistrimin në mënyrë automatike ose gjysmë-automatike të detajeve të lëvizjes së këtyre automjeteve dhe të periudhave të caktuara të punës së drejtuesve të tyre;

(b) Fletë regjistrimi do të thotë:

një fletë e modeluar për të marrë dhe mbajtur të dhënat e regjistruara, e cila vendoset në pajisjen e regjistrimit dhe mbi të cilën pajisjet shënjuese të së dytës bëjnë, në mënyrë të vazhdueshme, regjistrimin e informacionit që duhet regjistruar;

(c) Konstante e pajisjes së regjistrimit do të thotë:

karakteristika numerike që jep vlerën e sinjalit hyrës që kërkohet për të treguar dhe regjistruar distancën e përshkuar prej një kilometri; kjo konstante duhet shprehur ose në rrotullime për kilometër ($k = \dots$ rrotullime/km), ose në impulse për kilometër ($k = \dots$ impuls/km);

(d) Koeficienti karakteristik i mjeteve:

karakteristika numerike që jep vlerën e sinjalit dalës të lëshuar nga pjesa e automjetit që e lidh atë me pajisjen e regjistrimit (boshti ose aksi dalës i kutisë së shpejtësisë) teksa automjeti përshkon një distancë prej një kilometri të matur në kushte normale testimi (shih Kapitullin VI, pika 4 e kësaj Shtojce). Koeficienti karakteristik shprehet ose në rrotullime për kilometër ($w = \dots$ rrotullime/km), ose në impulse për kilometër ($w = \dots$ impuls/km);

(e) perimetër efikas i rrotave do të thotë:

mesatarja e distancave të përshkuara nga disa rrota (rrotat drejtuese) gjatë një rrotullimi të plotë. Matja e këtyre distancave duhet bërë në kushte normale testimi (shih Kapitullin VI, pika 4 e kësaj Shtojce) dhe shprehet në formën : $l = \dots$ mm.

II. KARAKTERISTIKA DHE FUNKSIONE TE PËRGJITHSHME TË PAJISJES SË REGJISTRIMIT

Pajisja duhet të jetë në gjendje të regjistrojë sa më poshtë vijon:

1. distancën e përshkuar nga automjeti;
2. shpejtësinë e automjetit;
3. kohën e drejtimit;
4. periudha të tjera pune ose disponueshmërie;
5. pushimet gjatë punës dhe periudhat e pushimit ditor;

6. hapjen e kutisë që mban fletën e regjistrimit.

Për automjetet që përdoren nga dy drejtues, pajisja duhet të jetë në gjendje të regjistrojë njëkohësisht, por në mënyrë të dallueshme dhe në dy fleta të ndara regjistrimi, të dhënat e periudhave të renditura sipas 3, 4 dhe 5.

III. KËRKESAT E PRODHIMIT TË PAJISJES SË REGJISTRIMIT

(a) Pika të përgjithshme

1. Pajisja e regjistrimit duhet të përmbajë sa më poshtë vijon:

1.1. instrumentet vizuale që tregojnë:

- distancën e përshkuar (regjistruerin e distancës),
- shpejtësinë (shpejtësimatësin),
- kohën (orën).

1.2. Pajisja regjistruese që përbëhet nga sa më poshtë vijon:

- një regjistruer i distancës së përshkuar,
- një regjistruer shpejtësie,
- një ose më shumë regjistruer kohe për plotësimin e kërkesave të parashikuara në Kapitullin III (c) 4.

1.3. Një pajisje shënjuese që tregon në fletën e regjistrimit çdo hapje të kutisë që mban atë fletë.

2. Çdo futje në pajisje të pajisjeve shtesë, përveç atyre të renditura më sipër, nuk duhet të ndërhyjë në funksionimin e duhur të pajisjeve të detyrueshme apo në leximin e tyre.

Pajisja duhet dorëzuar për miratimin e plotë dhe me të gjitha pajisjet e tjera të tilla shtesë.

3. Materialet

3.1. Të gjitha pjesët përbërëse të pajisjes së regjistrimit duhet të prodhohen me materiale që kanë qëndrueshmëri dhe forcë mekanike të mjaftueshme dhe karakteristika të qëndrueshme elektrike dhe magnetike.

3.2. Çdo modifikim i një pjese përbërëse të pajisjes apo i natyrës së materialeve të përdorura për prodhimin e saj duhet përpara se të përdoret në prodhim, të dorëzohet për miratim pranë autoriteteve, të cilat kanë dhënë miratimin e tipit për pajisjen.

4. Matja e distancës së përshkuar

Distancat e përshkuara mund të maten dhe të regjistrohen ose:

- me qëllim që të përfshihen të dyja lëvizjet vajtje dhe ardhje, ose
- me qëllim që të përfshihet vetëm vajtja.

Çdo regjistrim i lëvizjeve të kthimit nuk duhet në asnjë mënyrë të prekë qartësinë dhe saktësinë e regjistrimeve të tjera.

5. Matja e shpejtësisë

5.1. Shkalla e matjes së shpejtësisë duhet shprehur në certifikatën e miratimit të tipit.

5.2. Frekuenca natyrale dhe aftësia amortizuese e pajisjes matëse duhet të jenë të tilla që instrumentet që tregojnë dhe regjistrojnë shpejtësinë mund të ndjekin, brenda shkallës së matjes, ndryshimet e shpejtësisë prej deri në 2 m/s², brenda kufijve të tolerancave të pranuar.

6. Matja e kohës (ora)

6.1. Kontrolli i mekanizmit për rivendosjen e orës duhet të vendoset brenda një kutie që përmban fletën e regjistrimit; çdo hapje e kësaj kutie duhet të regjistrohet automatikisht në fletën e regjistrimit.

6.2. Nëse mekanizmi i lëvizjes përpara i fletës së regjistrimit kontrollohet nga ora, periudha gjatë së cilës e dyta do të ecë në mënyrë të saktë pasi të jetë kurdisur plotësisht, duhet të jetë, të paktën, 10% më e madhe se periudha e regjistrimit që korrespondon me ngarkesën maksimale të fletës së pajisjes.

7. Ndriçimi dhe Mbrojtja

7.1 Instrumentet vizuale të pajisjes duhen pajisur me ndriçim të mjaftueshëm jo verbues.

7.2. Për kushte normale përdorimi, të gjitha pjesët e brendshme të pajisjes duhet të jenë të mbrojtura kundrejt lagështirës dhe pluhurit. Gjithashtu, ato duhen bërë të mbrojtura nga ndërhyrjet duke i futur në kuti që mund të vulosen.

(b) Instrumentet vizuale

1. Treguesi i distancës së përshkuar (regjistruesi i distancës)

1.1. Vlera e shkallëzimit më të vogël në instrument që tregon distancën e përshkuar duhet të jetë 0,1 kilometra. Shifrat që tregojnë hektometra duhet të jenë qartësisht të dallueshme nga ato që tregojnë kilometrat e tëra.

1.2. Shifrat në regjistruesin e distancës duhet të jenë qartësisht të lexueshme dhe duhet të kenë një lartësi të dukshme prej të paktën 4 mm.

1.3. Regjistruesi i distancës duhet të jetë në gjendje të lexojë deri në, të paktën, 99 999,9 kilometra.

2. Treguesit e shpejtësisë (shpejtësimatësi)

2.1. Brenda gamës së matjes, shkalla e shpejtësisë duhet të gradohet me 1, 2, 5 ose 10 kilometra në orë. Vlera e shkallëzimit të shpejtësisë (shpejtësia ndërmjet dy shenjave të njëpasnjëshme) nuk duhet të kalojë 10% të shpejtësisë maksimale të treguar në shkallë.

2.2. Shkalla e treguar tej asaj që është matur nuk duhet shënuar me shifra.

2.3. Gjatësia e çdo hapësire në shkallën që përfaqëson një ndryshim shpejtësie prej 10 kilometrash në orë nuk duhet të jetë më pak se 10 milimetra.

2.4. Tek treguesi me gjilpërë, distanca ndërmjet gjilpërës dhe faqes së instrumentit nuk duhet të kalojë tre milimetra.

3. Treguesi i kohës (ora)

Treguesi i kohës duhet të jetë i dukshëm nga jashtë pajisjes dhe të japë një lexim të qartë, të thjeshtë dhe të kuptueshëm.

(c) Instrumentet e regjistrimit

1. Pika të përgjithshme

1.1. Të gjitha pajisjet, pavarësisht nga forma e fletës së regjistrimit (shirit apo disk) duhen pajisur me një shenjë që mundëson futjen e fletës së regjistrimit në mënyrë të saktë, me qëllim që të sigurojë se koha e treguar nga ora dhe shënimi i kohës në fletë të korrespondojnë.

1.2. Mekanizmi që lëviz fletën e regjistrimit duhet të jetë i tillë që të sigurojë që fleta e regjistrimit lëviz në mënyrë precize ndërkohë që mund të futet e të hiqet lirisht.

1.3. Për fletët e regjistrimit në formën e diskut, pajisja e lëvizjes përpara duhet kontrolluar nga mekanizmi i orës. Në këtë rast, lëvizja rrotulluese e fletës duhet të jetë e vazhdueshme dhe

uniformë, me një shpejtësi minimale prej shtatë milimetrash në orë e matur në kufirin e brendshëm të rrethit që shënon anën e fushës së regjistrimit të shpejtësisë.

Në pajisjet e llojit shirit, ku pajisja e lëvizjes përpara e fletëve kontrollohet nga mekanizmi i orës, shpejtësia e lëvizjes drejtvizore duhet të jetë, të paktën, 10 milimetra në orë.

1.4. Regjistrimi i distancës së përshkuar, i shpejtësisë së automjetit dhe i çdo hapje të kutisë që mban fletën ose fletët e regjistrimit duhet të jetë automatik.

2. Regjistrimi i distancës së përshkuar

2.1. Çdo kilometër distancë e përshkuar duhet paraqitur në regjistrim me një ndryshim prej, të paktën, një milimetri në koordinatën korresponduese.

2.2. Edhe në shpejtësitë që arrijnë kufirin e sipërm shkallës së matjes, regjistrimi i distancave duhet të jetë gjithnjë qartësisht i lexueshëm.

3. Regjistrimi i shpejtësisë

3.1. Pavarësisht nga forma e fletës së regjistrimit, maja shkruese e regjistrimit të shpejtësisë duhet të lëvizë normalisht në vijë të drejtë dhe në kënde të drejta në drejtim të lëvizjes së fletës së regjistrimit.

Megjithatë, lëvizja e majës shkruese mund të jetë vijëlakuar, me kusht që të plotësohen kushtet e mëposhtme:

- shenja e shkruar nga maja shkruese duhet të jetë perpendikulare me perimetrin mesatar (në rastin e fletëve në formën e diskut) ose me boshtin (në rastin e fletëve të regjistrimit në formë shiriti) të fushës së rezervuar për regjistrim shpejtësie,

- raporti ndërmjet rrezes së lakimit të gjurmës së shënuar nga maja shkruese dhe gjerësisë së fushës së rezervuar për regjistrim shpejtësie nuk duhet të jetë më pak se 2,4 deri në 1, pavarësisht nga forma e fletës së regjistrimit,

- shënimi në shkallën e kohës duhet të kalojë fushën e regjistrimit në një kurbë me të njëjtën rreze si dhe gjurma e shënuar nga maja shkruese. Hapësirat ndërmjet shenjave në shkallën e kohës duhet të paraqesin një periudhë që nuk kalon një orë.

3.2. Çdo ndryshim i shpejtësisë prej 10 kilometrash në orë duhet paraqitur në regjistrim me anë të një variacioni prej, të paktën, 1,5 milimetrash në koordinatën korresponduese.

4. Regjistrimi i kohës

4.1. Pajisja e regjistrimit duhet të jetë e ndërtuar në mënyrë të tillë që të jetë e mundur që, nëpërmjet përdorimit të një pajisje çelës kur është e nevojshme, të regjistrohet në mënyrë automatike dhe të ndarë në katër periudha kohe siç tregohet në nenin 15 të rregullores.

4.2. Duhet të jetë e mundur, nisur nga karakteristikat e gjurmëve, të pozicioneve të tyre relative dhe nëse është e nevojshme, shenjat e përshkruara në nenin 15 të rregullores për të bërë në mënyrë të qartë dallimin ndërmjet periudhave të ndryshme të kohës.

Periudhat e ndryshme të kohës duhen dalluar nga njëra-tjetra në regjistrim nëpërmjet ndryshimeve në trashësinë e gjurmëve përkatëse, ose nëpërmjet ndonjë sistemi tjetër me të paktën, efektshmëri të barabartë nga pikëpamja e lexueshmërisë dhe e lehtësisë së interpretimit të regjistrimit.

4.3. Në rastin e automjeteve me ekuipazh që përbëhet prej më shumë së një drejtues, regjistrimet e përcaktuara në pikën 4.1 duhen bërë në dy fletë të ndara, ku secila prej fletëve i jepet një drejtuesi. Në këtë rast, lëvizja përpara e fletëve të ndara duhet ndikuar ose nëpërmjet një mekanizmi të vetëm ose nëpërmjet dy mekanizmave të sinkronizuar të ndarë.

(d) Pajisja mbyllëse

1. Kutia që mban fletën apo fletët e regjistrimit dhe kontrollin e mekanizmit për rivendosjen e orës duhet të pajiset me një kyç.

2. Çdo hapje e kutisë që përmban fletën apo fletët e regjistrimit dhe kontrollin e mekanizmit për rivendosjen e orës duhet të regjistrohet në mënyrë automatike tek fleta ose tek fletët.

(e) Shenjat

1. Shenjat e mëposhtme duhet të shfaqen në faqen e instrumentit të pajisjes:

- afër shifrës së treguar nga regjistruesi i distancës, njësia e matjes së distancës, e treguar nga shkurtimi 'km',

- afër shkallës së shpejtësisë, shenja 'km/h',

- shkalla e matjes së shpejtësimatësit në formën 'Vmin . . . km/h, Vmax . . . km/h', Kjo shenjë nuk është e domosdoshme nëse tregohet në pllakën përshkruese të pajisjes.

Megjithatë, këto kërkesa nuk zbatohen ndaj pajisjeve të regjistrimit të miratuara përpara datës 10 Gusht 1970.

2. Pllaka përshkruese duhet instaluar në pajisje dhe duhet të tregojë shënimet e mëposhtme, të cilat duhet të jenë të dukshme tek pajisja kur instalohet:

- emri dhe adresa e prodhuesit të pajisjes,

- numri i prodhuesit dhe viti i prodhimit,

- shenja e miratimit për llojin e pajisjes,

- konstantja e pajisjes në formën 'k = . . . rrotullime/km' or 'k = . . . impulse/km',

- në mënyrë fakultative, shkalla e matjes së shpejtësisë, në formën e treguar në Piken 1,

- nëse sensitiviteti i instrumentit ndaj këndit të animit është i aftë të ndikojë tek leximet e dhëna nga pajisja jashtë tolerancave të lejuara, këndi i lejueshëm shprehet në formën e mëposhtme:

ku a është këndi i matur nga pozicioni horizontal i faqes së parme (i vendosur në mënyrë të drejtë lart) të pajisjes, për të cilën instrumenti është i kalibruar, ndërkohë që v dhe g paraqesin respektivisht devijimet maksimale të lejueshme lart dhe poshtë nga këndi i kalibrimit a .

(f) Tolerancat maksimale (vizuale dhe instrumentet e regjistrimit)

1. Në bankëprovë përpara instalimit:

(a) distanca e përshkuar:

1 % më shumë ose me pak sesa distanca reale, kur kjo distancë është, të paktën, një kilometër;

(b) shpejtësia:

3 km/h më shumë ose më pak sesa shpejtësia reale;

(c) koha:

± dy minuta në ditë me një maksimale prej 10 minutash për shtatë ditë në rastet kur periudha e ecjes së orës pas rikurdisjes nuk është më pak se kjo periudhë.

2. Në instalim:

(a) distanca e përshkuar:

2 % më shumë ose më pak sesa distanca reale, kur kjo distancë është, të paktën, një kilometër;

(b) shpejtësia:

4 km/h më shumë ose më pak sesa shpejtësia reale;

(c) koha:

± dy minuta në ditë, ose

± 10 minuta për shtatë ditë.

3. Në përdorim:

(a) distanca e përshkuar:

4 % më shumë ose më pak sesa distanca reale, kur kjo distancë është, të paktën, një kilometër;

(b) shpejtësia:

6 km/h më shumë ose më pak sesa shpejtësia reale;

(c) koha:

± dy minuta në ditë, ose

± 10 minuta për shtatë ditë.

4. Tolerancat maksimale të përcaktuara në pikat 1, 2 dhe 3 janë të vlefshme për temperaturat ndërmjet 0 ° dhe 40 °C, temperatura që merren shumë pranë pajisjes.

5. Matjet e tolerancave maksimale të përcaktuara në pikat 2 dhe 3 duhet të bëhen sipas kushteve të parashikuara në Kapitullin VI. IV.

IV. FLETËT E REGJISTRIMIT

(a) Pika të përgjithshme

1. Fletët e regjistrimit duhet të jenë të tilla që të mos pengojnë funksionimin normal të instrumentit dhe regjistrimet që ato përmbajnë janë të pashlyeshme dhe lehtësisht të lexueshme dhe të identifikueshme.

Fletët e regjistrimit duhet të mbajnë dimensionet e tyre dhe regjistrimet e bëra mbi to sipas kushteve normale të lagështirës dhe temperaturës.

Gjithashtu, duhet të jetë e mundur të shkruhet mbi fletët, pa i dëmtuar ato dhe pa prekur lexueshmërinë e regjistrimeve, informacioni i përmendur në nenin 15 pika (5) të rregullores.

Në kushtet normale të ruajtjes, regjistrimet duhet të mbeten qartësisht të lexueshme për, të paktën, një vit.

2. Kapaciteti minimal regjistruar i fletëve, pavarësisht nga forma e tyre, duhet të jetë 24 orë.

Nëse disqe të ndryshme lidhen së bashku për të rritur kapacitetin e regjistrimit të vazhdueshëm, gjë e cila mund të arrihet pa ndërhyje nga ana e personelit, lidhjet ndërmjet disqeve të ndryshme duhen bërë në mënyrë të tillë që të mos ketë ndërprerje apo mbivendosje të regjistrimeve në pikën e transferimit nga njëri disk tek tjetri.

(b) Fushat e regjistrimit dhe shkallëzimi i tyre

1. Fletët e regjistrimit duhet të përfshijnë fushat e mëposhtme të regjistrimit:

- një fushë e rezervuar ekskluzivisht për të dhënat që lidhen me shpejtësinë,

- një fushë e rezervuar ekskluzivisht për të dhënat që lidhen me distancën e përshkuar,

- një ose më shumë fusha të rezervuara për të dhënat që lidhen me kohën e drejtimit të automjetit, me periudha të tjera të punës dhe me disponueshmërinë ndaj pushimeve gjatë punës dhe periudhave të pushimit për drejtuesit.

2. Fusha për regjistrimin e shpejtësisë duhet shkallëzuar në ndarje prej 20 kilometrash në orë ose më pak. Shpejtësia që korrespondon me secilën shenjë në shkallë duhet treguar në shifra kundrejt asaj shenje. Simboli 'km/h' duhet treguar, të paktën, njëherë brenda fushës. Shenja e fundit në shkallë duhet të korrespondojë me kufirin e sipërm të shkallës së matjes.

3. Fusha për regjistrimin e distancës së përshkuar duhet paraqitur në mënyrë të tillë që numri i kilometrave të përshkuara të mund të lexohet pa vështirësi.

4. Fusha ose fushat e rezervuara për regjistrimin e periudhave të përmendura në pikën 1 duhet të jetë ose të jenë të shënuara në mënyrë të tillë që të jetë e mundur të dallohet në mënyrë të qartë ndërmjet periudhave të ndryshme të kohës.

(c) Informacioni që shtypet në fletët e regjistrimit

Çdo fletë duhet të mbajë, në formë të shtypur, informacionin e mëposhtëm:

- emrin dhe adresën ose emrin tregtar të prodhuesit,
- shenjën e miratimit të modelit të fletës,
- shenjën e miratimit të llojit apo të llojeve të pajisjeve në të cilat mund të përdoret fleta,
- kufiri i sipërm i shkallës së matjes së shpejtësisë e shtypur në kilometra në orë.

Nëpërmjet kërkesave minimale shtesë, çdo fletë duhet të përmbajë, në formë të shtypur, një shkallë kohore të shkallëzuar në mënyrë të tillë që ajo të mund të lexohet drejtpërsëdrejti në intervale prej pesëmbëdhjete minutash, ndërkohë që çdo interval prej pesë minutash të mund të përcaktohet pa vështirësi.

(d) Hapësirë e lirë për ndërhyrjet me shkrim dore

Në fletët e regjistrimit duhet siguruar një hapësirë e lirë e tillë që drejtuesit të mund të shkruajnë minimalisht detajet e mëposhtme:

- mbiemrin dhe emrin e drejtuesit,
- datën dhe vendin ku fillon përdorimi i fletës dhe datën e vendin ku përfundon një përdorim i tillë,,
- targa ose targat e automjetit ose të automjeteve që i janë caktuar drejtuesve për të drejtuar gjatë përdorimit të fletës,
- leximet e odometrit të automjetit apo të automjeteve që i janë caktuar drejtuesit për të drejtuar gjatë përdorimit të fletës,
- koha në të cilën ndodh ndonjë ndryshim i automjetit.

V. INSTALIMI I PAJISJES SË REGJISTRIMIT

1. Pajisja e regjistrimit duhet pozicionuar në automjet në mënyrë të tillë që drejtuesi të ketë nga sedilja e tij një pamje të qartë të shpejtësimatësit, të regjistruarit të distancës dhe të orës ndërkohë që, njëherazi, të gjitha pjesët e këtyre instrumenteve, duke përfshirë pjesët e drejtimit, janë të mbrojtura kundër dëmtimeve aksidentale.

2. Duhet të jetë e mundur që të përshtatet konstantja e pajisjes së regjistrimit me koeficientin karakteristik të njetit me anë të një pajisjeje të përshtatshme, e njohur si përshtatësi.

Automjetet me dy ose më shumë raporte aksesh duhen pajisur me një pajisje çelës, ku këto raporte të ndryshme të mund të sillen në mënyrë automatike në linjë me raportin për të cilin pajisja është përshtatur me automjetin.

3. Pasi të jetë kontrolluar instalimi i pajisjes, në automjet vendoset një pllakë instalimi pranë pajisjes ose në vetë pajisjen, dhe në mënyrë të tillë që të jetë qartësisht e dukshme. Pas çdo inspektimi nga një montues ose njësi riparimi e miratuar, kur kërkohet një ndryshim në ndërtimin e vetë pajisjes, në vend të pllakës së mëparshme duhet vendosur një pllakë e re instalimi.

Pllaka duhet të tregojë, të paktën, detajet e mëposhtme:

- emrin, mbiemrin ose emrin tregtar të montuesit ose të njësisë së miratuar të riparimit,
- Koeficientin karakteristik të automjetit, në formën ' $w = . . .$ rrotullime/km' or ' $w = . . .$ impulse/km',
- perimetrin efikas të rrotave në formën ' $l = . . .$ mm',
- datat në të cilat koeficienti karakteristik i automjetit është përcaktuar dhe perimetrin e matur efikas të rrotave.

4. Vulosja

Pjesët e mëposhtme duhen vulosur:

- (a) pllaka e instalimit, në rast se ajo nuk është fiksuar në mënyrë të tillë që nuk mund të hiqet pa shkatërruar shënimet e vendosura në të;
- (b) dy pjesët fundore të lidhjes ndërmjet pajisjes së instaluar të regjistrimit dhe automjetit;
- (c) vetë përshtatësin dhe pikën e futjes së tij në qark;
- (d) mekanizmin çelës për automjete me dy ose më shumë raporte aksesh;
- (e) lidhjet që bashkojnë përshtatësin dhe mekanizmin çelës me pjesën tjetër të pajisjes;
- (f) kutitë e kërkuara sipas Kapitullit III (a) 7.2.

Në rastet e kutive të veçanta, mund të kërkohen vula të mëtejshme për miratimin e llojit të pajisjes dhe në certifikatën e miratimit duhet bërë një shënim për pozicionimin e këtyre vulave.

Vetëm vulat e përmendura tek (b), (c) dhe (e) mund të hiqen në rastet e emergjencës; për çdo rast që këto vula thyhen, duhet përgatitur dhe dërguar pranë autoritetit kompetent një deklaratë me shkrim që jep arsyet për një veprim të tillë.

VI. KONTROLLET DHE INSPEKTIMET

Shtetet Anëtare emërojnë organet, të cilat kryejnë kontrollet dhe inspektimet.

1. Çertifikimi i instrumenteve të reja ose të riparuar

Çdo pajisje e veçantë, pavarësisht nëse është e re apo e përdorur, certifikohet në funksion të përdorimit të saj korrekt dhe të saktësisë së leximeve dhe regjistrimeve të saj, brenda kufijve të përcaktuar në Kapitullin III (f) 1, me anë të vulosjes në përputhje me Kapitullin V (4) (f).

Për këtë qëllim, Shtetet Anëtare mund të parashikojnë një verifikim fillestar që përbehet nga një kontrollim i përputhjes së një pajisjeje të re ose të riparuar me modelin tip të miratuar dhe/ose me kërkesat e rregullores dhe të Shtojcave të saj ose mund të delegojë kompetencën për të certifikuar tek prodhuesit ose tek agjentët e tyre të autorizuar.

2. Instalimi

Kur vendoset në automjet, pajisja dhe i gjithë instalimi duhet të respektojnë dispozitat lidhur me tolerancat maksimale të përcaktuara në Kapitullin III (f) 2.

Testet e inspektimit kryhen nga një montues ose njësi riparimi e miratuar nën përgjegjësinë e tij ose të saj.

3. Inspektimet periodike

(a) Inspektimet periodike të pajisjeve të vendosura në automjete kryhen të paktën njëherë në dy vjet dhe mund të realizohen së bashku me testet e sigurisë rrugore të automjeteve.

Këto inspektime përfshijnë kontrollet e mëposhtme:

- që pajisja punon në mënyrë të saktë,
- që pajisja mban shenjën e miratimit tip,
- që pllaka e instalimit është e fiksuar,
- që vulat në pajisje dhe në pjesët e tjera të instalimit janë të paprekura,
- perimetrin faktik të rrotave.

(b) Inspektimi për të siguruar respektimin e dispozitave të Kapitullit III (f) 3 për tolerancat maksimale në përdorim duhet të kryhet, të paktën, njëherë në gjashtë vjet, megjithëse secili Shtet Anëtar mund të parashikojë një interval më të shkurtër për një inspektim të tillë për sa u përket automjeteve të regjistruara në territorin e tij. Inspektime të tilla duhet të përfshijnë zëvendësimin e pllakës së instalimit.

4. Matja e gabimeve

Matja e gabimeve në instalim dhe gjatë përdorimit realizohet sipas kushteve të mëposhtme, të cilat duhen konsideruar si kushtet përbërëse standarde të testimit:

- automjeti i pangarkuar, në kushte normale pune

- presioni i gomave në përputhje me udhëzimet e prodhuesit,
- konsumimi i gomave brenda kufijve të lejuar nga ligji,
- lëvizja e automjetit: automjeti duhet të ecë, i drejtuar nga motori i vet, në vijë të drejtë dhe në sipërfaqe të rrafshët me një shpejtësi prej 50 ± 5 km/h; testi mund të kryhet edhe në një bankëprovë të përshtatshme, me kusht që ai të ketë saktësi të krahasueshme.

SHTOJCA II SHENJA E MIRATIMIT DHE CERTIFIKATA

I. SHENJA E MIRATIMIT

1. Shenja e miratimit përbëhet nga:

- një drejtkëndësh, brenda të cilit vendoset shkronja 'e' e pasuar nga një numër ose shkronjë dalluese për vendin që ka bërë miratimin në përputhje me shenjat e mëposhtme konvencionale:

1.2 // Belgjika // 6, // Danimarka // 18, // Gjermania // 1, // Greqia // GR, // Spanja // 9, // Franca // 2, // Irlanda // IRL, // Italia // 3, // Luksemburgu // 13, // Holanda // 4, // Portugalia // 21, // Mbretëria e Bashkuar // 11,

dhe

- një numër miratimi që i korrespondon numrit të certifikatës së miratimit të formuluar për prototipin e pajisjes së regjistrimit apo të fletës së miratimit, të vendosur në cilëndo pikë ngjitur me këtë drejtkëndësh.

2. Shenja e miratimit duhet të tregohet në pllakën përshkruese të çdo grupi pajisjesh dhe në çdo fletë regjistrimi. Ajo duhet të jetë e pashlyeshme dhe gjithnjë duhet të mbetet qartësisht e lexueshme.

3. Dimensionet e shenjës së miratimit të përshkuar më poshtë shprehen në milimetra dhe këto dimensionet janë minimume. Raportet ndërmjet dimensioneve duhen ruajtur.

(1) Këto shifra tregohen vetëm për efekt udhëzimi.

II. CERTIFIKATA E MIRATIMIT

Shteti që ka dhënë miratimin duhet të pajisë kërkuuesin me një certifikatë miratimi, modeli i së cilës është dhënë më poshtë. Gjatë informimit të Shteteve Anëtare të tjera për miratimet e dhëna, ose nëse është rasti, për miratimet e revokuara, Shteti Anëtar përdor kopje të asaj certifikate.

CERTIFIKATA E MIRATIMIT

Emri i administratës kompetente

Njoftim lidhur me (1):

- miratimin e llojit të pajisjes së regjistrimit
- revokimin e miratimit të llojit të pajisjes së regjistrimit
- miratimin e modelit të fletës së regjistrimit
- revokimin e miratimit të modelit të fletës së regjistrimit

Miratim Nr.

1. Emri tregtar ose emri
2. Emri i tipit ose i modelit
3. Emri i prodhuesit
4. Adresa e prodhuesit
5. Dorëzuar për miratim me datën
6. Testuar me
7. Data dhe numri i raportit të testit
8. Data e miratimit
9. Data e revokimit të miratimit

10. Lloji ose llojet e pajisjes së regjistrimit në të cilin është modeluar për t'u përdorur fleta.
 11. Vendi
 12. Data
 13. Dokumentet përshkruese të bashkëlidhur
 14. Vërejtje
(Firma)
- (1) Fshirja e zërave e pazbatueshme.